



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:248356

Datë: 28.06.2024

Numri i dokumentit: 05876234

KPPP.nr.1878/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbartimore të kreditorit Komuna e Prishtinës, me seli në Prishtinë, rruga “UÇK” nr.2, kundër debitorit M.B. B.I., me NUI: 810913790, me seli në Prishtinë, rruga “Eqrem Qabej”, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.401/23 të datës 17.08.2023, të Përmbartuesit Privat Destan Bujupaj, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 28.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i pa bazuar prapësimi i debitorit M.B. B.I., dhe ANULOHET Urdhri Përmbartimor P.nr.401/23 i datës 17.08.2023, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Destan Bujupaj,.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka caktuar urdhrin përmbartimor P.nr.401/23 të datës 17.08.2023, duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm - Faturës Nr.201912791 të datës 20.12.2022, me të cilin e ka detyruar debitorin që në emër të përmbartjes së obligimeve nga fatura, t’ia paguaj shumën e përgjithshme prej 750.00 €, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore nën kërcënimin e përmbartimit me dhunë, me bartjen e mjeteve financiare nga llogaria bankare e debitorit në llogarinë e veçantë bankare të kreditorit, me regjistrimin, konfiskimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme në pronësi të debitorit dhe pagesën e borxhit nga shitja e këtyre sendeve.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, e ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor duke theksuar se kreditori në faturën e cila është objekt i kësaj procedure

përmbare e ka përfshirë edhe borxhin e vjetër në shumë prej 500.00 €, i cili borxh është i parashkruar dhe nuk mund të jetë pjesë e kësaj fature. Tutje ka shtuar se kreditori nuk ka lëshuar fatura veç e veç për secilin vit por të gjitha i ka përfshirë në një faturë si borxh të akumuluar andaj mbi bazën e nenit 341 të LMD-së borxhi i kërkuar është borxh i parashkruar. I ka propozuar gjykatës që ta aprovoj prapësimin e debitorit, ta shfuqizoj urdhrin përmbareimor si dhe ta refuzoj kërkesën e kreditorit si të pa bazuar.

Kreditore në përgjigje në prapësim, ka theksuar se dokumenti përmbareues i nxjerr në procedurë administrative është bërë i përmbareueshëm sipas rregullave me të cilat rregullohet kjo procedurë, po ashtu referimi i rasteve tek përmbareuesi privat është bërë në përputhje me LPP-në. I ka propozuar gjykatës që ta refuzoj prapësimin e debitorit, ndërsa urdhrin përmbareimor ta vërtetoj.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbareimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbareimor duhet të anulohet, për arsye si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se: *“Përmbareimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbareim po qe se në të është treguar kreditore dhe debitor, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*. Me neni 37 të LPP-së, përcaktohet se: *“Kur propozimi për përmbareim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se dokumenti, përkatësisht Fatura Nr. 201912791 e datës 20.12.2022, mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri përmbareimor, nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se fatura në rastin konkret është lëshuar në mënyrë të njëanshme nga ana e kreditorit dhe nuk është pranuar nga debitor, përkatësisht nuk përmban nënshkrimin e as vulën e debitorit dhe nuk ka dëshmi se e njëjta është pranuar nga debitor.

Duke qenë se debitori nuk ka pranuar në mënyrë të rregullt faturën e lartcekur, si e tillë nuk mund të shërbejnë si dokument i besueshëm dhe nuk ka tipare të përmbareshmërisë, përderisa njëra palë procedurale - debitori nuk ka pranuar një detyrim që rrjedh nga fatura.

Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumentet mbi të cilat mbështetet propozimi për përbarim, e mbi bazën e të cilit Përmbareshi privat ka lejuar përbarimin, nuk ka tipare të përmbareshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbareshit duhet të anulohet.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 71 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1878/23, datë 28.06.2024

Gjyqtarja
Verona Dibra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.